

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## STATUTI

### I DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS

Sot, më datë \_\_.\_\_.2019, përpara meje, Noteri Publik, Alket B. SKENDAJ, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me adresë në Rr."Reshit COLLAKU" u paraqitën personat e mëposhtëm:

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, e quajtur më tej "Dhoma" është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në formën e një organizate jofitimprurëse, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kodin Civil, të ndryshuar, dispozitat e ligjit nr. 8788 "Për organizatat jofitimprurëse, ligjin 16/2018 "Për Diasporën", ligjin nr. 32/2018 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës", Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 19.07.2019 "Për financimin e projektit për Dhomën e Biznesit të Diasporës – krijimi dhe nxitja e investimeve të Diasporës në Shqipëri dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës" dhe për aq sa gjen zbatim, Ligji 9640, datë 9.11.2006, "Për Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë", i ndryshuar, si dhe dispozitat e Ligjit nr. 10 428, datë 2.06.2011 "Për të Drejtën Ndërkombëtare Private".

#### Kreu I

#### Dispozita të përgjithshme

##### Neni 1

#### Objekti i Statutit

Ky statut përcakton parimet bazë të funksionimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës, selinë, fushën e veprimtarisë, anëtarësimin e subjekteve, kriteret dhe kuotën e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të saj, përbërjen e mënyrën e funksionimit të organeve të Dhomës, burimet e saj financiare, etj.

##### Neni 2

#### Emri dhe statusi juridik

1. Emri i plotë i Dhomës është Dhoma e Biznesit të Diasporës. Emri i saj i shkurtuar është DHBD.
2. Emri i Dhomës në gjuhën angleze është *Diaspora Biznes Chamber*. Emri i shkurtuar i Dhomës në gjuhën angleze është DBC.
3. Dhoma themelohet si shoqatë me anëtarësi, e cila përbën një bashkim vullnetar të personave fizikë, ose juridikë që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe/ose jashtë vendit, të cilat zotërohen tërësisht ose pjesërisht nga shqiptarë të Diasporës si dhe nga persona fizikë, ose juridikë, vendas ose të huaj, bashkëpunëtorë të tyre.



### Neni 3

#### Parimet e veprimitarisë

1. Dhoma e bazon veprimtarinë e saj në parimin e respektimit, të mbrojtjes dhe të zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

### Neni 4

#### Selia, Logoja dhe Vula

1. Dhoma është një person juridik me selinë në adresën: *Rr. Ibrahim Rugova nr. 5, Sky Tower 13/3, Tiranë, Shqipëri.*
2. Logoja e Dhomës dhe vula e saj paraqesin një formë katrore, në sfondin e së cilës është pasqyruar një hartë e botës, me mbishkrimin: Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare.

### Neni 5

#### Vendi dhe kohëzgjatja e ushtrimit të veprimitarisë

1. Dhoma ushtron veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dhoma mund të ushtrojë aktivitet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Dhoma mund të krijojë degë, filiale dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit.
3. Dhoma e ushtron veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar.

### Neni 6

#### Misioni dhe qëllimi i veprimitarisë së Dhomës

1. *Mision i Dhomës konsiston në krijimin e një fryme bashkëpunimi ekonomik mbar shqiptar nëpërmjet nxitjes së investimeve direkte dhe partneriteteve, nëpërmjet ofrimit të informacionit të specializuar dhe profesional për të nxitur dhe orientuar sipërmarrjet dhe kapitalin investues të Diasporës në ekonominë e vendit.*
2. Qëllimet e veprimitarisë së saj përfshijnë:
  - a) Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të anëtarëve të Dhomës;
  - b) Rrjetëzimi i sipërmarrësve e i bizneseve të Diasporës dhe krijimi i lidhjeve ndërmjet këtyre bizneseve dhe organeve të administratës shtetërore në Shqipëri;
  - c) Nxitja dhe inkurajimi i sipërmarrjeve nga bizneset shqiptare të Diasporës në Shqipëri, për të krijuar vende të reja pune dhe për të rritur zhvillimin ekonomik;
  - ç) Ngritja e platformave të shkëmbimit të informacionit e të përvojës si dhe të ofertave tregtare ndërmjet sipërmarrjeve të Diasporës dhe bashkëpunëtorëve të tyre, në funksion të forcimit të prezencës ekonomike në Shqipëri dhe prurjes së investimeve të reja;
  - d) Advokimi për përmirësimin e politikave në kuadër të lehtësimit të tregtisë dhe investimeve të Diasporës në Shqipëri dhe ndikimi për lehtësimin e tregtisë;
  - dh) Kontributi në politikat zhvillimore dhe planet strategjike për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë;

- e) Mbështetja e nismave ekonomike të anëtarëve të Dhomës dhe organizimi i ndihmës për anëtarët e Dhomës, në zgjidhjen e çështjeve me natyrë ekonomike, organizative dhe juridike, që lidhen me çeljen, ose ushtrimin e një aktiviteti ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
- ë) Ndihmesa për bizneset vendase në penetrimin e tregjeve ndërkombëtare dhe rritjen e mundësive të tyre për eksport;
- f) Ndihmesa për bizneset e Diasporës në identifikimin e tregjeve me interes brenda dhe jashtë vendit dhe dhënia e opinionëve për sektorë të caktuar të biznesit me kërkesë të anëtarit të Dhomës;
- g) Ofrimi i dijeve dhe shkëmbimi i përvojave e njohurive në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe përsosjes profesionale të anëtarëve të Dhomës;
- gj) Integrimi i anëtarëve të Dhomës në mjediset përkatëse, në të cilat ata veprojnë, përmes aktiviteteve të ndryshme me natyrë kulturore e shoqërore;
- h) Formimi dhe përhapja e parimeve të përgjegjësisë shoqërore dhe të etikës në veprimtarinë ekonomike.

## Neni 7

### Format e veprimtarisë së Dhomës

1. Dhoma i realizon qëllimet dhe detyrat e saj statutores, me anë të këtyre veprimtarive, por pa u kufizuar në to:
  - a) Bashkëpunimi me organet e pushtetit qendror e vendor, me organizata të tjera shoqërore dhe ekonomike, me qëllim krijimin e kushteve për çeljen dhe ushtrimin e veprimtarive nga ana e anëtarëve dhe të vetë Dhomës;
  - b) Organizimi i trajnimeve, konferencave, seminareve, si dhe ofrimi i ndihmës për zgjidhjen e problemeve ligjore, organizative dhe ekonomike, në fushat që lidhen me veprimtarinë ekonomike;
  - c) Organizimi dhe asistenca në organizimin e panairëve, ekspozitave, takimeve B2B ndërmjet sipërmarrësve;
  - ç) Hartimin e analizave periodike që lidhen me kushtet e ushtrimit të aktivitetit ekonomik të anëtarëve të Dhomës, paraqitja e rekomandimeve përkatëse që rrjedhin nga këto analiza, organeve kompetente të pushtetit qendror, ose vendor si dhe ofrimi i bashkëpunimit për realizimin e tyre;
  - d) Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit e përvojave me dhomat e tjera të tregtisë dhe industrisë në vend, ose gjetkë, urdhrat profesionalë si dhe me subjekte të tjera ku aderojnë subjektet që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike;
  - dh) Botimet në funksion të realizimit të qëllimeve statutores;
  - e) Lidhja e marrëveshjeve dhe kontratave me organet shtetërore, qendrore, ose vendore;
  - ë) Anëtarësimi në Bashkime, apo Federata, apo aderimi si palë në organizatat që bashkojnë sipërmarrësit;
  - f) Mjedise për zyra dhe telekomunikacion;
  - g) Shkëmbime delegacionesh dhe ndërmarrja e fushatave edukuese.

## Kreu II

### Seksioni I

#### Anëtarësia e Dhomës

##### Neni 8

#### Parimet e Anëtarësimit

1. Dhoma është një organizatë multi-sektoriale që pranon anëtarë pa kufizime në drejtim të sektorit të biznesit, ku operojnë.
2. Anëtarët e Dhomës janë persona fizikë dhe/ose juridikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe/ose gjetkë, të cilat zotërohen tërësisht ose pjesërisht nga shqiptarë të Diasporës si dhe nga persona fizikë dhe/ose juridikë, vendas a të huaj, bashkëpunëtorë të tyre.
3. Anëtarët e Dhomës mund të jenë sipërmarrësit e mëposhtëm:
  - a) Shoqëritë e kapitalit
  - b) Shoqëritë e personit
  - c) Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja
  - ç) Personat fizikë që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në emrin e vet
  - d) Shoqata, fondacione, qendra dhe organizata të tjera, që nuk ushtrojnë aktivitet ekonomik.
- dh) Anëtarë të Dhomës mund të jenë dhe individë me merita të spikatura, në cilësinë e anëtarëve honorifikë të saj. Anëtari i Dhomës me status honorifik nuk ngarkohet me detyrimin e parashikuar në nenin 9, par. 1 dhe 2. Anëtari honorifik merr pjesë në organet e Dhomës si anëtar konsultativ.
4. Diaspora, përfshin në përputhje me ligjin “Për Diasporën”
  - a. Komunitetet e hershme shqiptare në botë;
  - b. Çdo person, i cili është lindur në Shqipëri dhe jeton jashtë kufijve të saj;
  - c. Çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë

##### Neni 9

#### Kuotat e anëtarësisë

1. Kuotat e anëtarësisë ndahen në tre kategori:
  - 1.1. Kuotat e anëtarësisë për subjektet tregtare, persona juridikë, që punësojnë një numër prej 1-49 punonjësish, është 250 EUR,
  - 1.2. Kuotat e anëtarësisë për subjektet tregtare, persona juridikë, që punësojnë një numër prej 50 – 249 punonjësish është 500 EUR,
  - 1.3. Kuotat e anëtarësisë për subjektet tregtare, persona juridikë, që punësojnë një numër prej 250, ose një numër më të lartë punonjësish është 750 EUR,
  - 1.4. Kuota e anëtarësisë për personat fizikë është 250 EUR.
  - 1.5. Kuota e anëtarësisë për organizatat jofitimprurëse të organizuara në forma të ndryshme, si shoqata, fondacione, qendra, është 250 EUR.
2. Anëtari i ri i Dhomës detyrohet të paguajë gjithashtu një tarifë regjistrimi prej 150 EUR. Tarifa e regjistrimit paguhet vetëm një herë dhe është e pakthyeshme.

3. Kuota e anëtarësimit dhe tarifa e regjistrimit e anëtarit paguhet në bankën e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, në monedhën EUR, të çelur në emër dhe për llogari të Dhomës.
- 3.1 Kuota e anëtarësimit paguhet brenda datës 31 mars të vitit ushtrimor në vijim.
- 3.2 Tarifa e regjistrimit për anëtarët e rinj paguhet brenda tre muajve nga data e anëtarësimit
4. Kuotat e anëtarësimit dhe tarifa e regjistrimit mund të ndryshojë vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, me propozim të Kryesisë. Vendimi për ndryshimin e kuotave të anëtarësisë merret me shumicën prej dy të tretat në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve.
5. Kuoatat e anëtarësimit si dhe tarifatat e regjistrimit do të jenë falas deri në datën 12 Nëntor 2021.

#### **Neni 10**

##### **Pranimi i anëtarëve të rinj**

1. Vendimin lidhur me pranimin e anëtarëve të rinj e merr Asambleja e Dhomës, pas shqyrtimit të kërkesës nga ana e subjektit të interesuar. Refuzimi i kërkesës bëhet me vendim të arsyetuar me shkrim. Shkaqet për refuzimin e kërkesës nuk mund të jenë shkaqe diskriminuese ndaj subjektit, por vetëm shkaqe që lidhen me mospërmbushjen e kriterëve për të qenë Anëtar i Dhomës, sipas përcaktimeve të këtij statuti.
2. Mosmarrja e një vendimi brenda 3 ditëve kalendatrike nga dita e depozitimit të aplikimit pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës, është e barazvlefshme me miratimin e kërkesës në heshtje.

#### **Neni 11**

##### **Largimi i anëtarëve ekzistues**

Anëtari mund të largohet nga Dhoma, duke dërguar një njoftim për largimin të paktën tre muaj përpara. Largimi duhet të njoftohet në formë të shkruar dhe hyn në fuqi, në fund të muajit kalendarik. Anëtari ka detyrimin të paguajë proporcionalisht kuotën e papaguar deri në momentin e largimit.

#### **Neni 12**

##### **Pushimi i anëtarësisë**

1. Anëtarësia në Dhomë pushon:
  - a) Në ditën kur vendimi i gjykatës, ose i organit kompetent shtetëror për çregjistrimin e subjektit nga regjistri i përkatës, merr formë të prerë;
  - b) Në ditën e marrjes së vendimit nga ana e Asamblesë për përjashtimin nga radhët e anëtarit, për shkelje të rënda të ligjit, apo të statutit;
  - c) Me kalimin e periudhës së njoftimit të largimit të anëtarit nga Dhoma.

#### **Neni 13**

##### **Përjashtimi nga radhët e anëtarëve**

1. Përjashtimi nga radhët e anëtarëve bëhet me vendim të Asamblesë, në rastet kur anëtari:
  - a) Ushtron aktivitetin ekonomik në kundërshtim me parimet e etikës, ose zakonet e mira tregtare;
  - b) Shkel detyrimet e anëtarit të Dhomës;
  - c) Kryen veprime të konkurrencës së pandershme.
  - ç) Nuk paguan kuotën e anëtarësisë për tri periudha ushtrimore.

## **Seksioni II**

### **Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Dhomës**

#### **Neni 14**

##### **Të drejtat e anëtarëve të Dhomës**

1. Anëtari i Dhomës ka këto të drejta:
  - a) të jetë anëtar i Asamblesë së Anëtarëve dhe të votojë në të.
  - b) të marrë pjesë në mbledhjet e klubeve të anëtarëve dhe komisioneve të ngritura për çështje të caktuara, që veprojnë në Dhomë;
  - c) të përfitojë ndihmën dhe përvojën e Dhomës sipas parimeve të përcaktuara në Statut dhe rregulloret që nxirren në zbatim të tij,
  - ç) të paraqesë kërkesa për informacion referuar veprimtarisë së Dhomës dhe të marrë informacionin e kërkuar;
  - d) të përfitojë konsulencë nga ana e Dhomës në të gjitha çështjet që rrjedhin nga veprimtaria e anëtarëve, e në veçanti nga konsulenca në fushën ligjore, organizative dhe ekonomiko-financiare, sipas parimeve të përcaktuara në Statut dhe rregulloret që nxirren në zbatim të tij.

#### **Neni 15**

##### **Detyrimet e anëtarëve të Dhomës**

1. Anëtari i Dhomës ka këto detyrime:
  - a) të respektojë përcaktimet e statutit si dhe të vendimeve e të rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, dhe të organeve të zgjedhura të Dhomës;
  - b) të respektojë parimet etike të veprimtarisë ekonomike, zakonet e mira tregtare si dhe parimet e konkurrencës së ndershme;
  - c) me veprimin dhe qëndrimin e tij të kujdeset për emrin e mirë të Dhomës;
  - ç) të paguajë rregullisht kuotat e anëtarësisë;
  - d) të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve ku bën pjesë.
  - d) të paguajë tarifën e regjistrimit.

#### **Neni 16**

##### **Ushtrimi i të drejtave dhe detyrimeve nga anëtarët e Dhomës**

1. Anëtari i Dhomës që është person fizik i ushtron të drejtat dhe përmbush detyrimet e tij, personalisht, ose përmes përfaqësuesit të vet me prokurë;
2. Anëtari që është person juridik, përfaqësohet në Dhomë nga një person fizik, i cili është përfaqësuesi i tij ligjor, ose një person i autorizuar nga organi vendimmarrës, apo nga përfaqësuesi i tij ligjor, për ta përfaqësuar personin juridik në Dhomë;

## Neni 17

### **Konflikti i interesave dhe marrëveshjet e ndaluara**

Nuk lejohet konflikti i interesave ndërmjet Dhomës dhe anëtarit të organit vendimmarrës, ekzekutiv ose punonjësit të saj. Rastet e konflikteve dhe procedurat e zgjidhjes së tyre parashikohen në statut dhe në akte të tjera ligjore.

Marrëveshjet ndërmjet Dhomës dhe një anëtari të organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive ose një punonjësi të saj mund të lejohen vetëm nëse ato lidhen për të përmbushur një qëllim ose objekt të veprimtarisë së Dhomës, vetëm nëse janë të drejta dhe në përputhje me vlerën reale të tregut. Këto marrëveshje mund të lejohen vetëm nëse shqyrtohen paraprakisht nga organet drejtuese. Personat e interesuar duhet të përjashtohen nga diskutimet dhe votimi për marrëveshjen.

Në rast konflikti i interesave ose marrëveshje të ndaluara ose të konsumuar dhe në rast se procedurat e mësipërme nuk janë ndjekur, Dhoma mund ta anulojë këtë marrëveshje dhe të ngrejë padi për dëmshpërblim në gjykatë.

## Neni 18

### **Zgjidhja e konfliktit të interesave**

Çdo anëtar i organit më të lartë vendimmarrës ose ekzekutiv të Dhomës duhet të tërhiqet nga shqyrtimi dhe marrja e vendimit për çdo çështje që ai ose familjarët e tij kanë interesa të drejtpërdrejta ose të tërthortë ekonomike ose vetjakë.

Çdo transaksion financiar për llogari të Dhomës, ndërmjet një anëtari të organit vendimmarrës, atij ekzekutiv a një punonjësi të saj, si dhe një personi tjetër juridik dhe fizik, kur anëtari i organit vendimmarrës, atij ekzekutiv ose punonjësi i Dhomës ka interes financiar, mund të përfundohet vetëm nëse organi më i lartë vendimmarrës e lejon atë dhe nëse ky transaksion përmban kushte më të favorshme për Dhomën.

Punonjësit e paguar nuk mund të jenë anëtarë të organit vendimmarrës të Dhomës. Ata mund të marrin pjesë në mbledhjet e tyre pa të drejtë vote.

### **Kreu III**

#### **Organet e Dhomës**

##### **Seksioni I**

##### **Organi më i lartë vendimmarrës**

##### **Neni 19**

##### **Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve**

1. Organi më i lartë vendimmarrës i Dhomës është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të saj.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët. Nëse numri i anëtarëve të Dhomës, kalon pragun e 50 anëtarëve, anëtarët e Dhomës delegojnë përfaqësimin e interesave të tyre në Dhomë, te një përfaqësi, sipas sektorëve ekonomikë, në përpjesëtim me numrin e anëtarëve, që secili sektor ekonomik ka në Dhomë. Sektorët ekonomikë ndahen në: industri nxjerrëse, manufakturë dhe shërbime.
3. Në organet e zgjedhura të Dhomës, sigurohet pjesëmarrja e të paktën 50 përqind të anëtarëve nga Diaspora. Nëse përqindja e vendeve të rezervuara brenda një sektori ekonomik, për anëtarët e Diasporës nuk shfrytëzohet, sipas parashikimit të mësipërm, nga anëtarë të Diasporës, për mungesë të tyre, ato shpërndahen ndërmjet anëtarëve të tjerë, brenda të njëjtit sektor, sipas renditjes së tyre.
4. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve, dhe vendos me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
5. Për ndryshimin e statutit të Dhomës vendimmarrja e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve bëhet me shumicën e anëtarëve të saj.

##### **Neni 20**

##### **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve**

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve mund të krijojë organizma të tjerë vendimmarrës, ekzekutivë ose këshillimorë, si kur e lejon statuti ashtu edhe kur statuti nuk e pengon shprehimisht.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej saj, ka këto detyra:

- a) vendos për ndryshimin e statutit;
- b) vendos për pranimin e anëtarëve të rinj;
- c) vendos për zgjedhjen, ose emërimin apo shkarkimin e anëtarëve të Kryesisë, të Kryetarit të Dhomës, si dhe të përfaqësuesve të Dhomës në të tjera Dhoma, Bashkime, Federata, apo organizata të tjera të biznesit, ku Dhoma vendos të aderojë apo të anëtarësohet.
- d) përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë, si dhe mbikëqyr e kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
- ç) miraton pasqyrat financiare që paraqiten nga organi ekzekutiv, ku jepen me hollësi burimet materiale e financiare, përdorimet e tyre dhe pasuritë e Dhomës;
- d) miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Dhomës dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm;



dh) vendos caktimin e ekspertëve të jashtëm të auditimit, për të kontrolluar rast pas rasti shpenzimet financiare të kryera nga Dhoma gjatë realizimit të veprimtarisë së saj dhe për ushtrimin e kontrolleve tematike, duke përfshirë edhe ato të kryera për veprimtari të përbashkëta me organizata të tjera.

e) krijon komitete të posaçme;

g) mbikëqyr veprimtarinë e Dhomës.

gj) vendos edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut.

## **Neni 21**

### **Shpërblimi i anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve**

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, si rregull, ushtrojnë funksionin e tyre pa shpërblim.

Dhoma, në respektim të parimit të interesit më të mirë të saj, në varësi të kushteve të saj, të numrit dhe të kohëzgjatjes së mbledhjeve, mund të rimbursojë shpenzimet dhe të shpërblejë në mënyrë të arsyeshme anëtarët e organit më të lartë drejtues për pjesëmarrjen në mbledhjet e tij.

## **Neni 22**

### **Votimi**

1. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, anëtarët votojnë personalisht, ose përmes përfaqësuesve të tyre.
2. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve mund të marrin pjesë në punimet e mbledhjes dhe të votojnë edhe përmes mjeteve audiovizive, të cilat mundësojnë identifikimin e qartë të pamjes dhe zërit të anëtarit që merr pjesë dhe voton në këtë mënyrë.
3. Me përjashtim të rasteve kur në këtë Statut parashikohet ndryshe, Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve merren me shumicë të thjeshtë votash, në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve.

## **Neni 23**

### **Thirrja e mbledhjes**

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.
2. Mbledhja e zakonshme, thirret nga Kryetari i Dhomës, të paktën një herë në vit.
3. Mbledhja e jashtëzakonshme, thirret nga Kryetari i Dhomës, nga të paktën një e treta e anëtarëve të Kryesisë, ose nga të paktën një e treta e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.
4. Thirrja e mbledhjes duhet të përmbajë datën, orën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës dhe të gjitha materialet mbështetëse që përlligjin propozimet që do të shqyrtohen në mbledhje. Brenda mundësive, në thirrjen për mbledhjen duhet të përfshihen edhe projekt-vendimet, që do të shqyrtohen gjatë mbledhjes. Nëse të pranishëm në mbledhje janë më shumë se 75% e anëtarëve të Asamblesë, rendit të ditës mund t'i shtohen pika të tjera, nëse janë dakord shumica e prej tre të katërtave e anëtarëve të pranishëm.
5. Thirrja e mbledhjes duhet t'iu njoftohet anëtarëve të Dhomës, jo më vonë se 60 ditë nga dita e zhvillimit të mbledhjes. Shkresa për thirrjen e mbledhjes iu dërgohet anëtarëve të Dhomës edhe me postë elektronike, në adresat e anëtarëve të depozituara pranë Dhomës.

## **Seksioni II**

### **Organi ekzekutiv**

#### **Neni 24**

#### **Kryesia**

1. Organi ekzekutiv është Kryesia e Dhomës. Ajo përbëhet nga Kryetari dhe nga pesë anëtarë, që emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me shumicë të thjeshtë votash në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve.
2. Mandati i Kryetarit dhe i anëtarit të Kryesisë zgjat katër vjet.
3. Kryetari i parë dhe anëtarët e parë të Kryesisë së Dhomës emërohen në mbledhjen e parë të themeluesve me një mandat që zgjat katër vjet nga dita kur Dhoma fiton personalitetin juridik, pas regjistrimit në Gjykatën e Rrethit, Tiranë.
4. Kryetari dhe anëtarët e Kryesisë së re, me përfundimin e periudhës së sipërpërmendur zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
5. Në Kryesi, Diaspora shqiptare përfaqësohet me të paktën 50 përqind të vendeve.

#### **Neni 25**

#### **Kompetencat e Kryesisë**

1. Kryesia ka këto kompetenca:
  - a) Miraton programet e punës, që lidhen me detyrat dhe objektivat e Dhomës.
  - b) Miraton strukturën organizative dhe funksionet e aparatit administrativ të Dhomës, pagat e punonjësve, si dhe emëron Drejtorin Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv është funksionar me kohë të plotë, kompetencat dhe detyrat e të cilit përcaktohen në statut.
  - c) Miraton rregulloren e brendshme të aparatit administrativ të Dhomës.
  - d) Shqyrton programin vjetor financiar dhe buxhetin përpara se t'i paraqitet asamblesë për miratim.
  - e) Cakton shpërblimet për ekspertët, në veçanti ekspertët që ushtrojnë auditimin e jashtëm të veprimtarisë së Dhomës.
  - f) Cakton rregullat për përdorimin e fondeve dhe administrimin e tyre.
  - g) Propozon ndryshimet në statutin e Dhomës.
  - h) Përcakton rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë së Dhomës.
  - i) Merr vendime për të gjitha çështjet që shtrohen për shqyrtim në kryesi nga kryetari i Dhomës.
2. Kryesia është përgjegjëse për:
  - a) zbatimin e vendimeve të asamblesë;
  - b) mbarëvajtjen e veprimtarisë së Dhomës.

## Neni 26

### Vendimmarrja e Kryesisë

1. Kryesia mblidhet, si rregull, një herë në muaj nga kryetari i Dhomës.
2. Kryesia mund të mblidhet kurdoherë me propozim nga një e treta e anëtarëve të saj.
3. Mbledhja e Kryesisë është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Mbledhja drejtohet nga kryetari dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të Kryesisë, i caktuar nga kjo e fundit.
4. Vendimet e Kryesisë nënshkruhen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të saj, i caktuar nga kjo e fundit për të drejtuar mbledhjen, sipas paragrafit më lart.
5. Vendimet e Kryesisë janë të vlefshme kur për to votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rastin e barazisë së votave, vota e Kryetarit do të jetë vota përcaktuese.
6. Mbledhjet e Kryesisë mund të zhvillohen edhe me përdorimin e mjeteve audiovizive, të cilat bëjnë të mundur dallimin e pastër të zërit dhe të pamjes së anëtarëve të Kryesisë.

## Neni 27

### Kryetari i Dhomës

1. Kryetari drejton veprimtarinë e Dhomës dhe kryesinë e saj. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Dhomës.
2. Kryetari ka të drejtën e vendimmarrjes për bashkëpunime, partneritete, projekte etj, mes Dhomës së Biznesit të Diasporës dhe institucioneve, OJF-ve, agjencive dhe organeve të tjera potenciale për bashkëpunim etj.
3. Kryetari përfaqëson Dhomën në marrëdhëniet me të tretët, sipas përcaktimeve të statutit dhe legjislacionit në fuqi.
4. Kryetari është funksionar dhe paguhet nga Dhoma.

## Neni 28

### Emërimi dhe Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të Kryesisë së Dhomës

1. Kryetari i dhomës dhe anëtari i Kryesisë së Dhomës emërohen më vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, me shumicë të thjeshtë në praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve.
2. Kryetari i dhomës dhe anëtari i Kryesisë së Dhomës mund të shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, me shumicë të thjeshtë në praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve, kur:
  - a. shpallet fajtor për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë
  - b. shkel diaspozitat e dsatutit
  - c. i sjell dëme Dhomës me veprimet e tij të kryera me dashje ose pakujdesi të rrëndë.

## Neni 29

### Drejtori Ekzekutiv i Dhomës

1. Drejtori ekzekutiv i Dhomës është pjesë e aparatit administrativ të saj dhe emërohet nga Kryetari i Dhomës.
2. Drejtori ekzekutiv kujdeset për mbajtjen e regjistrit të anëtarëve dhe përditësimin e tij, sipas rregullave të parashikuara në Statut dhe në rregullore të brendshme si dhe ushtron detyrën në vijim të udhëzimeve të Kryetarit të Dhomës.
3. Drejtori ekzekutiv është funksionar me kohë të plotë i Dhomës.

## Neni 30

### Shpërblimi i Kryetarit, anëtarëve të Kryesisë dhe punonjësve të tjerë të Dhomës

Anëtari ose anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv dhe punonjësit e organizatës jofitimprurëse për punën e kryer përfitojnë pagë, shpërblime dhe rimbursim për shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre, në përputhje me rregulloret e brendshme, të nxjerra në zbatim të këtij Statuti.

## Neni 31

### Buxheti dhe burimet e financimit të Dhomës

1. Dhoma harton çdo vit kalendarik buxhetin e vet vjetor.
2. Dhoma siguron të ardhura nga burime të ligjshme dhe bën shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, për të cilin është krijuar, si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së saj.
3. Burimet e të ardhurave të Dhomës janë të ardhurat nga kuotat vjetore të anëtarësisë, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të Dhomës.
4. Dhoma ka të drejtë të marrë pjesë si të gjithë personat e tjerë juridikë në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse.
5. Dhoma do të ushtrojë çdo veprimtari ekonomike ose joekonomike me kusht që të ardhurat ose pasuritë e saj, kur ka të tilla, të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e Dhomës.
6. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e Dhomës prej personave që janë subjekte të statutit ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Dhomës

## **Kreu IV**

### **Shpërndarja e Dhomës**

#### **Neni 32**

### **Shpërndarja e Dhomës**

1. Dhoma mund të shpërndahet me iniciativën e saj, ose me vendim të gjykatës.
2. Shpërndarja e dhomës me iniciativën e saj bëhet me anë të vendimit për shpërndarjen të marrë nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, me shumicë të cilësuar të votave prej dy të tretave, në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve. Vendimi tregon edhe likuidatorët e Dhomës dhe tagrat e përfaqësimit të tyre.
3. Në rastin e shpërndarjes me iniciativë, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve, pasuritë e mbetura i shpërndahen një ose më shumë organizatave jofitimprurëse në Shqipëri dhe/ose gjetkë.

#### **Neni 33**

### **Përgjegjësia civile dhe penale e Dhomës**

1. Dhoma ka përgjegjësi civile dhe penale si person juridik.
2. Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive si dhe punonjësit e Dhomës nuk përgjigjen për detyrimet ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur, gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje, ose nga pakujdesia e rëndë i kanë shkaktuar dëm të tretëve.
3. Përgjegjësia penale e Dhomës përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për përgjegjësinë penale të personave juridikë.

#### **Neni 34**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Statuti, fillimisht kërkohet të zgjidhet me mirëkuptim.

Në rastet kur mirëkuptimi nuk arrihet, organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit, Tiranë.

#### **Neni 35**

### **Dispozita kalimtare dhe të fundit**

Mbledhja e parë e anëtarëve themelues të Dhomës zgjedh Kryetarin e Dhomës dhe anëtarët e Kryesisë, mandati i të cilëve zgjat deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe të anëtarëve të Kryesisë, sipas parashikimeve të këtij statuti.